

REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e IX-të për vitin 2013, e Kuvendit Komunal në Vushtrri, mbajtur më 10.09.2013

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit komunal, duke filluar në orën 10:15.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri: Abdullah Vojvoda, Arta Ismajli, Avdullah Halimi, Bahrije Pllana, Besim Jashari, Esat Beka, Gjylsime Feka, Habib Mustafa, Habibe Gërxhaliu, Hajrulla Muli, Islam Krasniqi, Ismet Gashi, Makfirete Ademi, Merjeme Ismajli, Melihate Basholli, Muharrem Shabani, Naile Osmani, Pajazit Pllana, Qazim Azemi, Refik Ramaj, Remzije Isufi, Sabit Kadriu, Sabri Ferati, Selim Rrustemi, Selvete Sholla, Syzana Sylja, Shpëtim Zhegrova, Veli Karaça, Xhemajl Pllana, Vlora Qirezi dhe Zeqir Hasani.

Munguan: Ergin Sunguri, Ferit Idrizi, Nysret Gërxhaliu, anëtarë të kuvendit.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës, nënkryetari i komunës, drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësuesi i OSBE-së dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Habib Mustafa - kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës.

Debat lidhur me rendin e ditës:

Besim Jashari, anëtar i kuvendit - në emër të Grupit kuvendar të LDK-së ngriti çështjet që janë në interes të përgjithshëm të qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë, siç janë: çështja e furnizimit me ujë, përkatësisht përfundimi i projektit për ndërtimin e fabrikës së ujit, prandaj është e nevojshme të informohemi se deri ku kanë arritur punimet dhe a do të përfundojë projekti në afatin e paraparë, pasi që dihen vuajtjet e qytetarëve për mungesën e furnizimit me ujë për vite me radhë; çështja tjetër është problemi i eksploatimit ilegal të thëngjillit në fshatrat rrëzë Çyqavicës, duke shtuar se ka qenë edhe një rast tragjik ku ka humbur jetën një 17 vjeçar dhe rikujtoi se çështjen e eksploatimit ilegal të thëngjillit e kemi ngritur në mbledhjen e KK-së në nëntor të vitit 2012, duke e konsideruar si një problem shumë serioz, prandaj kërkoi nga kryetari i komunës që të informojë kuvendin se çka është ndërmarrë në bashkëpunim me autoritetet qendrore lidhur me këtë problem, dhe kërkoi që të adresohet çështja e përgjegjësisë. Po ashtu ngriti çështjen e problemit të ruajtjes së pyjeve, pasi që është një pasuri jashtëzakonisht e rëndësishme kombëtare, por edhe pasuri e vlefshme për komunën tonë, duke shtuar se jemi dëshmitarë të prerjes ilegale të pyjeve dhe

shndërrimit të atyre pyjeve në sipërfaqe të zhveshura dhe në këtë kontekst përmendi edhe çështjen e katër rojeve të pyjeve, të cilët kanë qenë të punësuar me kontratë, ku të njëjtëve iu ka përfunduar kontrata, prandaj kërkoi që të shqyrtohet mundësia e angazhimit të tyre të mëtejme pasi që është me interes për komunën dhe mbrojtjen e pyjeve në Komunën e Vushtrrisë. Në vazhdim përmendi çështjen e sigurisë, duke shtuar se ka shumë raste të aksidenteve me pasoja fatale gjatë kësaj vere edhe në Komunën e Vushtrrisë, prandaj në mbledhjet e kaluara të KK-së është kërkuar që të vijë komandanti i Stacionit të Policisë për të raportuar dhe informuar lidhur me gjendjen e sigurisë në komunën tonë, për masat që po merren, por edhe të dëgjojë shqetësimet dhe propozimet e anëtarëve të kuvendit, me qëllim që çështja e sigurisë të ngritet në nivelin më të lartë. Në fund kërkoi të diskutohet për dinamikën e realizimit të projekteve kapitale, konkretisht projektet në rrugën "Dëshmorët e Kombit", pasi që nuk ka ardhur asnjë njoftim se kur do të përfundojnë punimet, duke shtuar se ka zvarritje të kryerjes së punimeve, pasi që në shumë ditë të mira nuk po punohet fare.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit - në emër të Grupit kuvendar të AAK-së paraqiti tri probleme që duhet të shqyrtohen duke i futur në rend dite: zgjidhja e kryetarëve nëpër këshillat e fshatrave, duke përmendur rastin e fundit të zgjidhjes së kryetarit të këshillit të fshatit në Maxhunaj, pasi që janë shkelur procedurat, duke u zgjedhur kryetar i këshillit të fshatit personi i cili është kryetar i nëndegës së PDK-së dhe janë anashkaluar kërkesat e përfaqësuesve të katër lagjeve, kështu që kjo zgjedhje është bërë në mënyrë të anshme dhe joligjore, prandaj kërkoi nga kryetari i komunës që të rishqyrtohet ky problem; çështja e peticionit të lagjes në rrugën "Isak Halili", të cilët në peticion sqarojnë se katër vite me radhë kërkojnë shtrimin e rrugës së tyre edhe pse kjo rrugë është dëmtuar nga kompania "Hysi" dhe po ajo nuk e ka kthyer rrugën në gjendjen e mëparshme e cila rrugë është në gjendje të mjerueshme, duke shtuar se në peticion përmendet edhe kryetari i komunës, disa drejtorë dhe në mënyrë të veçantë përmendet edhe anëtari i kuvendit Shpëtim Zhegrova, i cili ka premtuar rregullimin e rrugës në fjalë. Në fund përmendi problemin e pranimit të profesorëve dhe mësuesve nëpër shkolla, prandaj është dashtë të kemi një informatë për pranimin e kuadrit nëpër shkolla, pasi që ka një sërë ankesash, sepse nuk është respektuar konkursi dhe janë refuzuar ata që kanë punuar 20 vite në arsim, siç është rasti në shkollën profesionale, pastaj është rasti tjetër në shkollën teknike kur refuzohet kandidati me master, ndërsa pranohet kandidati me baçelor, kurse në vazhdim përmendi emrat që nuk janë pranuar: Astrit Shartari me master (të njëjtit iu ka bërë e padrejtë edhe vitin e kaluar), Sejdi Ademi, Azem Jonuzi, Astrit Jasahri dhe Rafet Imeri, prandaj tha se pa kuadër cilësor nuk ka cilësi në mësim.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit - duke iu referuar çështjeve të ngritura nga anëtarët e kuvendit, tha se deri në fundin e këtij viti ose në fillim të vitit tjetër pritet fillimi i funksionimit të fabrikës së ujit. Pastaj propozoi që pika nr. 3 e rendit të ditës të zhvendoset dhe të shqyrtohet si pikë e dytë e rendit të ditës. Kurse sa i përket peticionit, tha se e ka propozuar për rregullim rrugën "Isak Halili" dhe e njëjta në vitin 2010 është votuar në kuvend, por anëtarët e kuvendit nuk mund të shkojnë nëpër shtëpi të tyre për të kërkuar participimin e tyre.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit - kërkoi që njoftohen anëtarët e kuvendit lidhur me atë se deri ku kanë shkuar punimet në fabrikën e ujit sepse është shqetësim i madh edhe i qytetarëve. Pastaj lidhur me punimet në rrugën "Dëshmorët e Kombit", tha se është për t'u habitur sepse me 7-8 punëtorë kompania kurrë nuk mund t'i kryejë punimet, prandaj kërkoi nga kryetari i komunës që inspektorët dhe përgjegjësit për mbikëqyrjen e këtyre punimeve të jenë të pranishëm çdo ditë dhe t'i përcjellin punimet hap pas hapi, për arsye se qytetarët janë duke u maltretuar në një afat më të gjatë se që ka qenë nevoja. Në vazhdim tha se është në kompetencën e komunës që ta paraqesë si një problem (të cilin e ka përmendur edhe më herët) mungesën e shenjave të komunikacionit në magjistralen Vushtrri-Skënderaj, duke shtuar se banorët e fshatrave që lidhen me këtë rrugë për çdo ditë janë të kërcënuar nga rreziku për vdekje, prandaj

është nevojë e domosdoshme që sa më shpejt të vendosen shenjat e komunikacionit. Në fund, sa i përket tragjedisë që ka ndodhur në fshatrat ku po eksploatohet thëngjilli, tha se edhe më herët në dy mbledhje të KK-së e kemi ngritur problemin në fjalë, kurse na është thënë se ky nuk është problem i yni, prandaj për të mos ndodhur kjo duhet të jemi më azhur.

Veli Karaça, anëtar i kuvendit - ngriti çështjen e organizimit të ekskursioneve në Shqipëri për nxënësit e shkollave të mesme, prandaj pyeti kryetarin e komunës dhe drejtorin e arsimit se a është kjo çështje biznesi apo është aktivitet programor i planifikuar, pasi që kjo është bërë obligim për të gjithë nxënësit, prandaj nëse është çështje biznesi, kush përfiton prej këtij biznesi e nëse është çështje obligative programore, atëherë profesorët që i shoqërojnë nxënësit duhet t'i kenë mëditjet dhe t'ju hiqen shpenzimet, duke shtuar se nuk po mund të pajtohet me faktin që është obligim që për çdo vit nxënësit t'i vizitojnë të njëjtat vende dhe të krijojnë shpenzime, duke shtuar se për disa nxënës që nuk janë në gjendje të mirë ekonomike, shpenzimet e tyre duhet t'i kryejë institucioni e jo të profesorëve, të cilët duhet të kenë mëditje. Në fund tha se nuk po e kupton se çka po përfitojnë nxënësit nga ky ekskursion, përveç që po humbin orë mësimore dhe po bëhet biznes, pasi që ka ndodh që pas çdo ekskursioni dikush të blejë veturë.

Gjylsime Feka, anëtare e kuvendit - tha se ekskursionet nuk po organizohen vetëm sivjet, por ekskursione të tilla po organizohen prej vitit 2004. Kurse akuzat se pas ekskursioneve po ndodh blerja e veturave duhet të paraqiten në prokurori e jo në kuvendin e komunës.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit - shprehu keqardhjen që kryesuesi i kuvendit po qëndron mbi Rregulloren e Punës së Kuvendit, pasi që neni 19.1 i kësaj rregulloreje thotë: "para miratimit të rendit të ditës, anëtarët e kuvendit mund të diskutojnë për çështje që nuk janë të parapara në rendin e ditës". Po ashtu tha se kryesuesi i kuvendit duhet të na prijë me respektimin e Rregullores së punës së kuvendit e jo të na prijë me shkeljen e kësaj rregulloreje, me arsyen se nuk e mban në vend të dukshëm kartelën e identifikimit.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - duke iu referuar diskutimeve të anëtarëve të kuvendit u përgjigj me sa vijon: çështja e furnizimit me ujë dhe dinamika e zhvillimit të punimeve në fabrikën e ujit, tha se shumë herë e kemi përmendur që Vushtrria është në gjendje të rëndë sa i përket furnizimit me ujë të pijshëm dhe shtoi se fabrika e ujit është duke u ndërtuar dhe është projekt i Ministrisë së Financave dhe i njëjti është projekt trevjeçar, kurse afati i përfundimit të punimeve është në fund të këtij viti dhe njoftoi se ka bërë shumë presion që punimet të kryhen në fund të qershorit ose në fund të korrikut, po ashtu edhe në Shipol është duke u zgjeruar fabrika e ujit, ku përmes një donacioni të jashtëm janë në procedurë për vendosjen e një gypi magjstral prej Shipolit për Vushtri, për t'i ikur kyçjeve ilegale që janë bërë. Kurse lidhur me shfrytëzimin ilegal të thëngjillit, tha se shqetësimi i qytetarëve është edhe më i hershëm sesa koha kur ka ndodhur tragjedia, por edhe autoritetet lokale janë angazhuar edhe më herët pa ndodhur tragjedia për të parandaluar një fenomen të tillë me ç'rast njoftoi se nuk është në kompetencë të komunës për të lëshuar leje për shfrytëzim të thëngjillit ose xeheve tjera minerale, por është kompetencë e Komisionit të Pavarur të Minierave dhe Mineraleve, mirëpo duhet ta ngrehim zërin në vazhdimësi, ashtu siç e kemi ngritur edhe në të kaluarën për ta ndaluar eksploatimin ilegal të thëngjillit. Ndërkaq lidhur me problemin e ruajtjes së pyjeve, tha se gjendja në menaxhimin e pyjeve në këtë vit është më e mirë se herëve tjera, duke njoftuar se janë angazhuar edhe katër punëtorë me kontratë mbi vepër, pasi që numri i rojave të pyllit është i vogël dhe të njëjtëve iu ka skaduar afati 6-mujor, kurse vazhdimin e kontratave nuk e lejon ligji. Në vazhdim njoftoi se çështja e shfrytëzimit ilegal të thëngjillit dhe çështja e mbrojtjes së pyjeve janë debatuar edhe në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi, ndërsa lidhur me dinamikën e realizimit të projekteve, tha se në cilësinë e kryetarit të komunës është duke bërë presion të vazhdueshëm në ekzekutivin e komunës dhe në kompani për përsheptimin e

punëve në finalizimin e projekteve të nisura, duke shtuar se është njoftuar që deri në fund të tetorit do të përfundojë projekti në rrugën "Dëshmorët e Kombit". Mandej lidhur me zgjedhjen e kryetarëve të këshillit të fshatrave, tha se interesimi i tij është që çdo fshat ta ketë kryetarin e vet, pa marrë parasysh përkatësinë partiake të tyre. Në fund lidhur me kërkesën për vendosjen e shenjave të komunikacionit në magjistralen Vushtrri-Skënderaj, kërkoi nga drejtori i urbanizmit që ta bëjë një kërkesë në Ministrinë e Infrastrukturës, për vendosjen e shenjave të komunikacionit.

Bajram Beqiri, drejtor i DI-së - informoi anëtarët e kuvendit të komunës për masat që janë ndërmarrë nga Drejtoria për Inspektime në lidhje me pengimin e eksploatimit ilegal të thëngjillit.

Qerim Selimi, drejtor i DA-së - informoi anëtarët e kuvendit të komunës lidhur me mënyrën e pranimit të kadrove nëpër shkolla, duke shtuar se pranimi bëhet konform dispozitave ligjore, gjithashtu informoi edhe për mënyrën e organizimit të ekskursioneve me maurantë, për të cilin organizim Ministria për Arsimit ka nxjerrë edhe udhëzim administrativ. Po ashtu tha se edhe zgjedhja e drejtorëve dhe ushtruesve të detyrës bëhet në bazë të ligjit.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit - tha se është shqetësuese dëmtimi i rrugëve, pasi që ato që po ndërtohen sot, po dëmtohen menjëherë nesër me pesha të rënda të pajisjeve që bartin materialin për autostradë dhe pyeti se a ka ndonjë vendim që rrugët ku pajisjet pa regjistrime qarkullojnë nëpër fshatra të caktuara, prandaj është detyrë e inspeksionit që së bashku me policinë të marrë masa për të ndaluar një gjë të tillë për të vendosur rend dhe ligj.

Xhemajl Pllana, anëtar i kuvendit - lidhur me eksploatimin e thëngjillit, tha se në vitin e kaluar është vepruar në mënyrë ilegale, sepse kompanitë nuk kanë patur licencë nga KPMM-ja për shfrytëzim të thëngjillit, dhe rikujtoi se në mbledhjen e kaluar ka pyetur kryetarin e komunës dhe drejtorin e DA-së se në vitin e kaluar a janë furnizuar shkollat me thëngjill të kontrabanduar dhe me cilësi shumë të dobët, por për habi nga asnjëri nuk ka marrë përgjigje adekuate.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit - tha se po habitet nga drejtori i Drejtorisë për Arsimit që po i injoron fakultetet private, duke shtuar se fakultetet publike dhe private janë tonat. Pastaj tha se në arsim nuk është respektuar konkursi, pasi që ka raste që ka pranuar në punë edhe kadro që nuk e kanë pas të nustrifikuar diplomën dhe që vjen nga komuna tjetër, po ashtu nuk ka pranuar kadro me master.

Bajram Beqiri, drejtor i DI-së - tha se ka shumë raste që kompanitë kanë dëmtuar rrugët, por të njëjtat janë detyruar që t'i kthejnë rrugët në gjendjen e mëparshme duke bërë riasfaltime.

Qerim Selimi, drejtor i DA-së - tha se nuk është duke i injoruar kolegjet private, por atyre që kryejnë kolegje private, ligji ua ndalon të punojnë në arsim. Kurse rastet që nuk janë pranuar me master, kanë të bëjnë me drejtime që nuk janë adekuate për vendet e punës që kanë konkuruar. Në fund tha se furnizimi i shkollave me thëngjill në këtë vit është bërë nga një kompani nga Skënderaj.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, kuvendi me vota unanime miratoi këtë:

REND DITE

- 1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.**
- 2. Shqyrtimi i Draft-strategjisë për zhvillimin ekonomik të Komunës së Vushtrrisë, për vitet 2013/2018 (shqyrtimi i parë).**
- 3. Shqyrtimi i Draft-rregullores për rregullat dhe procedurat e ndërtimit të objekteve (shqyrtimi i dytë).**
- 4. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko-financiare dhe për zbatimin e planeve investuese në gjashtëmujorin e parë të vitit 2013.**

5. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e korrje-shirjeve dhe përgatitjet për mbjelljet vjeshtore.
6. Shqyrtimi i Draft-buxhetit për vitin 2014 (shqyrtimi i parë).
7. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit - kërkoi që të bëhen dy korrigjime në faqen nr. 16, ku në vend të mbiemrit Bara duhet të jetë Bala, dhe në vend të emrit Gani duhet të jetë Galip.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit - në faqe nr. 15 kërkoi të korrigjohet fjalia me këtë riformulim: “nga Pestova ka ardhur një listë me propozime e cila rrugës është ndryshuar me disa emra dhe në KPF nuk ka ardhur e njëjta listë që është propozuar në këshillin e fshatit, kurse një veprim i tillë është i kundërligjshëm”. Po ashtu në faqe nr. 18 kërkoi të shtohet edhe fjala “sipas vendbanimeve”, dhe shprehu shqetësimin e tij që një listë e tillë deri më sot nuk iu është ofruar, prandaj sërish kërkoi një listë të investimeve kapitale sipas vendbanimeve.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit - në faqe nr. 4 dhe nr. 8 fjalia “te thirrjet juridike” kërkoi që të riformulohet “te thirrjet në dispozitat ligjore”.

Aprovohet unanimisht procesverbali në fjalë, me vërejtjet e B. Jasharit, R. Ramajt dhe I. Gashit.

2. Shqyrtimi i Draft-strategjisë për zhvillimin ekonomik të Komunës së Vushtrrisë, për vitet 2013/2018 (shqyrtimi i parë).

Edmond Hajrizi, rektor i UBT-së- paraqiti sqarimet hyrëse lidhur me draft-strategjinë në fjalë.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit - tha se e ka propozuar edhe më herët që komuna të mbështetet nga një kompani e specializuar për ta pasur Strategjinë e zhvillimit lokal ekonomik. Pastaj shprehu brengosjen e tij që strategjia na ka ardhur shumë vonë, pasi që për ta studiuar një strategji të tillë dhe për të paraqitur vërejtje koha ka qenë shumë e mangët. Në vazhdim tha se në strategjinë në fjalë narrativi është përshkruar mirë, por ka edhe shumë të meta dhe dobësi, ku përmendi vizionin, duke shtuar se vizioni është një ëndërr sesi dëshiron të duket komuna jonë në të ardhmen, kurse kështu bëhet një përshkrim i gjendjes së tanishme dhe nuk fokusohet kryekëput tek e ardhmja. Po ashtu struktura e fjalive është jo e favorshme dhe lexoi këtë fjali: “Vushtrria është rajon me një rini të fuqishme, e cila kërkon arsim cilësor”, prandaj kjo nuk mund të figurojë në vizion, dhe vizioni duhet të jetë i shkurtë. Në vazhdim kërkoi sqarime për disa formulime të paraqitura në draft-strategjinë në fjalë. Gjithashtu duke e vlerësuar përmbajtjen e kësaj draft-strategjie tha se nuk është e matshme dhe nuk ka sajime konkrete. Mandej duke iu referuar analizës SWOT, tha se komasacioni nuk është renditur si përparësi, kurse mungesa e ujit të pijshëm nuk përmendet fare tek analiza SWOT, e që është alfa dhe omega e mirëqenies së qytetarëve dhe e zhvillimit ekonomik, si dhe lindjes dhe zhvillimit të bizneseve. Kurse tek problemet dhe sfidat zhvillimore nuk numërohen sfidat kryesore. Në fund tha se komuna ka pas një strategji më herët e cila ka qenë shumë konkrete dhe për kohën ka qenë shumë e avancuar, por e njëjta nuk është marrë fare për bazë, duke shtuar se ka mundur të futen elemente të saj në këtë draft-strategji, po ashtu shtoi se kjo draft-strategji nuk ka formësuar projekte konkrete të përcaktuara në kohë dhe kompatible me narrativin, si dhe draft-strategjia në fjalë nuk është e matshme, sepse duhet të jetë e matshme në mënyrë që të krahasohet implementimi i saj në kohë.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit - tha se draft-strategjia në fjalë është shumë e rëndësishme për komunën tonë, por ka pritur që hartuesit e tij do të thellohen në problematikë, sepse nëse shikohet në aspektin e përgjithshëm shihet se ka vetëm përshtetshmëri, prandaj është dashtë të paraqiten alternativat sesi do të zgjidhen problemet, dhe përmendi si shembull se brenda 5 vjeçarit të ardhshëm si do të zbutet problemi i papunësisë. Ndërkaq sa i përket fushës së arsimit, tha se godina janë ndërtuar, por ngritja e godinave nuk e ka zgjedhur problemin e kualitetit të arsimit, duke shtuar se as reformat në arsim nuk kanë ndikuar në ngritjen e cilësisë së arsimit, por vetëm e kanë devalvuar çështjen e arsimit, prandaj pyeti sesi do të ngrihet cilësia e arsimit, kur kjo lëmi nuk varet vetëm nga ky plan strategjik, por varet nga Ministria e Arsimit.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit - tha se kjo draft-strategji është paksa e vonuar dhe këtë vonesë e ka kritikuar përfaqësuesi i AAK-së edhe në KPF, pasi që pa strategji nuk mund të punohet. Pastaj tek çështja e arsimit, tha se nuk është problem vetëm mosfunksionimi i këshillave të prindërve, por e keqja është që nuk funksionojnë as këshillat e shkollave dhe shtoi se me këtë draft-strategji është dashtë të kenë prioritet shkolla profesionale dhe shkolla teknike me ç'rast përmendi problemin e teksteve shkollore, të cilat janë botime të vjetra ose nuk ka fare në këto dy shkolla. Po ashtu problem është edhe kolapsi që kanë kompanitë publike pasi që nuk ka punëtori dhe pa punëtori nuk mund të realizohet praktika, kurse pa praktikë nuk mund të ketë cilësi në shkollat teknike dhe profesionale. Mandej lidhur me profilin e paraqitur të komunës në draft-strategjinë në fjalë, tha se Komunës së Vushtrrisë duhet t'i jepet edhe epiteti i qytetit monumental. Në vazhdim kërkoi që fjalja "pushteti komunist" të zëvendësohet me fjalinë "pushteti ushtarak serbo-sllav", kurse tek fuqia punëtore që është përmendur si potencial, tha se është mirë që të përmendet si dobësi se ky potencial (këta të rinj) po ik nga Kosova, duke shtuar se përveç të rinjve, nga Kosova po ikin edhe ekspertët. Tek SWOT analiza duhet të përmendet se një rrezik që na përcjellë është shkalla e lartë e korrupsionit. Në vazhdim tha se ky dokument ka mangësi gjuhësore, prandaj duhet të korrigjohet, ndërsa lidhur me kornizën makro-ekonomike, pyeti se a është reale rritja e ekonomisë prej 3.7 % në vitin 2013, kurse në vitin 2014 rritja e ekonomisë prej 4.3 %, në vitin 2015 rritja prej 4.6 %, pasi që dihet se shumë pak ka prodhimtari. Gjithashtu tha se nuk dihet a do të jenë shifra reale tek numri i popullsisë dhe tek numri i nxënësve që janë paraqitur në draft-strategjinë në fjalë.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit - duke iu referuar draft-strategjisë në fjalë, tha se nuk ka parë ndonjë njoftim i cili tregon sesi është punuar në këtë draft, dhe janë dy grupe punuese: grupi i udhëhequr nga përfaqësuesi të UBT-së dhe grupi i komunës, por nuk iu kujtohet nëse ka pasur ndonjë ftesë për ndonjë takim të përbashkët të këtyre dy grupeve e që do të ishte mirë të organizohej, prandaj propozoi që kjo të ndodh. Pastaj tha se ky dokument ka nevojë të filtrohet, pasi që janë disa gjëra që e ngarkojnë dokumentin dhe shtoi se kjo është një Draft-strategji për zhvillim ekonomik, prandaj edhe në narracion do të duhej të ishte fokusi te zhvillimi ekonomik, por edhe tek profili i komunës ai kërkoi të mos hyhet në përshtetshmëri të historisë, mirëpo të fokusohet vetëm në profilin ekonomik të Komunës së Vushtrrisë. Në fund i propozoi kryetarit të komunës që të angazhohet që këto dy grupe të ulen dhe diskutojnë bashkërisht në mënyrë që nga ky draft të del një dokument final i spastruar dhe i zbatueshëm.

Pajazit Pllana, anëtar i kuvendit - lidhur me draft-strategjinë në fjalë, tha se sa i përket segmentit të shëndetësisë i cili në disa emërtime nuk i përgjigjet konotacionit të natyrës së punës dhe përmendi fjalinë ku thuhet "sistemi i dobët i referimit", por nuk precizohet se a bëhet fjalë për nivelin primar apo sekondar. Kurse lidhur me interesin qytetar tha se komuna ka për obligim që qytetarëve të vet t'ua sigurojë konditat elementare mjekësore në kushtet dhe rrethanat që i ka, dhe ta ngrisë cilësinë duke iu ofruar atë që duhet të gjithë qytetarëve, në rend të parë nivelin primar, mjekësia familjare me të gjitha resurset që i ka, me shërbimet e stomatologjisë, laboratorit, rëntgenit, ndërsa ka mbetur një segment që nuk është përmendur fare e që është kujdesi ndaj nënës dhe fëmijut, pasi që është primare që ta ndërtojmë shoqërinë e shëndoshë, prandaj në këtë relacion

strategjia në fjalë duhet t'i përshtatet nivelit qendror dhe nivelit lokal, sepse shëndetësia ende nuk është prioritet në nivel të shtetit të Kosovës.

Zeqir Hasani, anëtar i kuvendit - duke iu referuar draft-strategjisë në fjalë, paraqiti këto vërejtje: te faqja nr. 10 shihet se edhe në hartimin e Strategjisë së komunës për zhvillimin ekonomik, nuk dihet saktë numri i të punësuarve dhe papunësia në Komunën e Vushtrrisë, por këto janë dy argumente pa të cilat strategjia nuk mund të finalizohet, sepse nëse thuhet se do të ulet papunësia në një përqindje të caktuar, atëherë duhet të dihet baza e përqindjes së papunësisë në këtë moment. Po ashtu tha se për krijimin e një strategjie, duhet të ketë impute të sakta, të cilat duhet të futen në strategji dhe ky dokument të finalizohet në mënyrë profesionale. Mandej tha se për hartimin e një strategjie të mirëfilltë zhvillimore, bazë janë katër shtylla: përparësitë, mundësitë, dobësitë dhe rreziqet, prandaj nëse arrihet që të identifikohen përparësitë, të shfrytëzohen mundësitë, të eliminohen dobësitë dhe të parashikohen rreziqet, atëherë do të bëhet një strategji e mirëfilltë e cila do të na drejtojë nga zhvillimi ekonomik. Gjithashtu tha se në këtë draft-strategji askund nuk është e fokusuar diaspora, si një bazë e zhvillimit ekonomik, kur dihet se deri në 15 milionë euro brenda vitit hyjnë në Vushtri nga diaspora dhe shtoi se me këtë strategji diasporës mund t'i krijohet një hapësirë për të investuar në Vushtri dhe kjo do të ishte edhe një bazë e zhvillimit ekonomik dhe e rritjes së punësimit. Kurse lidhur me rritjen e GDP-së, tha se është e pabesueshme që në vitin 2013 GDP-ja është 3.7 % në nivel të Republikës së Kosovës, dhe shtoi se sipas rekomandimeve të FMN-së do të jetë nën 3 %, pasi që ka rënie të zhvillimit ekonomik. Në vazhdim tha se në këtë draft-strategji është përdorur rreth 30 % Korniza Afatmesme Buxhetore, pra është përshkruar korniza që është votuar në kuvendin e komunës dhe nuk është paraqitur një vizion i qartë se brenda 5 viteve si do të duket Vushtria, si do të shfrytëzohen kapacitetet e Vushtrrisë, a ka mundësi Vushtria që me kapacitetet që i ka të ujit termal të krijojë ngrohje qendrore për tërë qytetin e Vushtrrisë, çfarë zhvillimi ekonomik do të ketë, si t'i krijohet mundësi dhe hapësirë zhvillimit të bujqësisë. Në fund lidhur me identifikimin e problemeve, tha se është pozitive që janë identifikuar këto probleme: zënia e tokave bujqësore me ndërtime të ndryshme; mosmbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe shtoi se nuk është cekur që për momentin problem akut për të gjithë qytetarët e Komunës së Vushtrrisë është furnizimi me ujë të pijshëm.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit - tha se rëndësia e këtij dokumenti është e madhe, por e keqja është që kjo draft-strategji ka ardhur me vonesë, pasi që Komuna e Vushtrrisë që nga viti 2007 ka funksionuar pa kurrfarë strategjie dhe pa kurrfarë programi zhvillimor edhe pse kjo ka qenë imperativ që të hartohet edhe më herët, në mënyrë që t'i kemi kahet e zhvillimit të paraqitura me të gjitha resurset që i kemi në komunë, se nga ta zhvillojmë komunën me ç'rast shtoi se në rastin konkret në këtë strategji do të ishte pozitive që të ketë shumë pjesëmarrës, për të dalë sa më reale dhe sa më objektive. Pastaj pyeti se nga do t'i kemi burimet e të hyrave, sepse nëse shikohet nga donacioni ose partneriteti publiko-privat si formë e zhvillimit, atëherë duhet shikuar se a e kemi ambientin e atillë në komunë, pasi që tash për tash jemi komuna e 26-të në Kosovë me ambient dhe lehtësira e që ne duhet t'i ndryshojmë në bazë të një vlerësimi të bërë nga USAID-i, pra edhe në burokraci, por edhe në ofrimin e të gjitha formave për investitorët e huaj, mirëpo është pikëpyetje edhe sa do të tërheqë komuna, sepse në bazë të legjislacionit komuna e ka pllafonin e ulët që të tërheqë ose të garantojë investime të jashtme, prandaj janë disa pragje që e vështirësojnë edhe çështjen sesi do të planifikohen. Mandej tha se do të ishte pozitive që të ketë një plan të veprimit rreth miratimit të strategjisë, sa do të ketë akterë për një pjesëmarrje sa më transparente dhe sa më të gjithanshme të të gjitha strukturave në këtë komunë, pra të gjitha rrjetet e shoqërive duke filluar nga ajo civile, shoqatat e biznesit dhe nga meset tjera, pasi që specifikat ndryshojnë në mënyrë që të konkretizohen të gjitha ato projekte që janë reale. Në vazhdim tha se në Komunën e Vushtrrisë dega kryesore e ekonomisë është bujqësia, por sa do të kemi zhvillim ekonomik në vitin 2014 me 169.000 euro të

planifikuara për bujqësi, prandaj kërkoi që strategjia të jetë konkrete, objektive, gjithëpërfshirëse dhe e matur në mënyrë konkrete me ato projekte që planifikohen për ndryshimin e gjendjes në komunë.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - lidhur me draft-strategjinë në fjalë, tha se ky dokument ka një rëndësi të veçantë dhe sqaroi se prej vitit 2009 komuna nuk ka strategji, duke shtuar se hartimi i draft-strategjisë në fjalë është bërë nga grupi punues shumëpartiak, pasi që kjo draft-strategji është në dobi të të gjithë qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë. Pastaj propozoi që gjatë diskutimit publik nga hartuesit të organizohet një dëgjim publik për të gjithë qytetarët e interesuar, e në veçanti për ekspertët. Në vazhdim tha se draft-strategjia në fjalë ka nevojë për korrigjim gjuhësor, por edhe për plotësime dhe ndryshime tjera.

Edmond Hajrizi, rektor i UBT-së - duke iu referuar pyetjeve, vërejtjeve dhe propozimeve gjatë diskutimeve të anëtarëve të kuvendit, paraqiti sqarime shtesë lidhur me draft-strategjinë në fjalë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Jepet në diskutim publik Draft-strategjia për zhvillimin ekonomik të Komunës së Vushtrrisë, për vitet 2013-2018.

Diskutimi publik fillon nga data 11.09.2013 dhe zgjat deri më 24.09.2013.

3. Shqyrtimi i Draft-rregullores për rregullat dhe procedurat e ndërtimit të objekteve (shqyrtimi i dytë).

Idriz Ismajli, drejtor i DUMM-së - paraqiti sqarime hyrëse lidhur me draft-rregulloren në fjalë.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit - lidhur me draft-rregulloren në fjalë, tek përmbajtja e nenit 6, tha se edhe aty ku ka plane rregulluese investitori (parashtruesi i kërkesës) për leje ndërtimore është i obliguar të pajiset me dokumentacionin mbi kushtet urbanistiko-teknike. Pastaj te neni 33.12 është një gabim teknik ku në vend të fjalisë "paragrafi 12" duhet të jetë "paragrafi 11". Mandej tha se te neni 45 është dashtë të jetë shënimi "kreu XI" dhe të thuhet për objektet e përkohshme. Në fund kërkoi nga kryetari i komunës dhe drejtori i urbanizmit, pasi që është vendimi i Inspektoratit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (më 10.07.2012) ku anulohen tri planet rregullative që janë aprovuar në kuvendin e komunës dhe kërkohet që të njëjtat të vijnë prapë në rishqyrtim në kuvendin e komunës, ku ndër të tjera thuhet: "gjithashtu lëshimi i lejes urbanistike bazuar në këto plane rregulluese do të jetë shkelje ligjore sipas Ligjit të Planifikimit Hapësinor", dhe shtoi se aq sa ka njohuri është vazhduar që të lëshohen leje dhe nuk është kthyer asnjëherë në rishqyrtim e që është obligim ligjor, por përgjegjësia mbetet mbi Drejtorinë e Urbanizmit dhe kryetarin e komunës.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit - lidhur me draft-rregulloren në fjalë, sa i përket neni 10.5.1., tha se nga përmbajtja e këtij neni janë duke u dëmtuar pronarët e parcelave, pasi që shumë pak po kanë mundësi të ndërtojnë në parcelat e veta, prandaj propozoi që të jetë 6 metra ku ka hapje dhe 3 metra ku nuk ka hapje, derisa të vjen në shqyrtim plani rregullativ dhe të bëhet parcializimi i pronave për ndërtim.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit - duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, tha se propozimi që është bërë lidhur me nenin 9 për t'u ndërruar prej 5 në 3 metra nuk është i arsyeshëm dhe nuk është i bazuar, prandaj propozoi që të mbetet 5 metra. Po ashtu e kundërshtoi propozimin e Sh. Zhegrovës, duke shtuar se është shumë më e arsyeshme të mbetet ashtu siç është në draft-rregullore. Në vazhdim paraqiti vërejtje tek kryerësi i punëve ndërtimore, duke propozuar që t'i shtohet një aline, sepse kryerësit e punëve ndërtimore po i dëmtojnë rrugët lokale, pasi që qarkullojnë me kamionë me pesha të ndaluara për ato rrugë, prandaj propozoi alinenë me këtë përmbajtje: "që të mos

dëmtohen rrugët lokale apo të kategorisë tjetër gjatë punës së ndërtimit me kamionë me peshë të rëndë, që nuk janë të lejuara të hyjnë në ato rrugë”.

Idriz Ismajli, drejtor i DUMM-së - lidhur me nenin 6, tha se ligji i ri për ndërtimet në mënyrë decisive thotë se ku ka plane rregulluese nuk merret leja urbanistike, kurse ku nuk ka plane rregulluese, hartuesi duhet të përgatit një miniprojekt në distancë prej 50 metra nga parcela e vet. Te neni 33.12 është një lëshim teknik, prandaj duhet të korrigjohet, kurse te neni 45 u pajtua që të ndahet me tekstin për kreun e ri, kurse lidhur me nenin 10.5.1, tha se kjo distancë në marrëveshje me fqin mund të zvogëlohet, por duke mos rrezikuar sigurinë për mbrojtje nga zjarri. Në vazhdim paraqiti sqarime shtesë lidhur me vërejtjet e anëtarëve të kuvendit për draft-rregulloren në fjalë.

Hajrulla Muli, anëtar i kuvendit - lidhur me nenin 10.5.1, tha se nëse distanca e përmendur është konform ligjit, atëherë le të mbetet ashtu edhe në rregullore.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit - duke iu referuar nenit 10.5.1, tha se nëse distanca është standard ligjor, atëherë le të mbetet e njëjta siç është përmendur në këtë nen.

Idriz Ismajli, drejtor i DUMM-së - tha se ligji nuk i parasheh metrat, mirëpo këtë çështje e parashohin rregullat dhe standardet e ndërtimit.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 17 vota “për”, 3 “kundër” vendosi me sa vijon:

Aprovohet Rregullorja për rregullat dhe procedurat e ndërtimit të objekteve, duke i inkorporuar disa nga vërejtjet dhe propozimet e anëtarëve të kuvendit.

4. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko-financiare dhe për zbatimin e planeve investuese në gjashtëmujorin e parë të vitit 2013.

Pajazit Pllana, anëtar i kuvendit - duke iu referuar raportit në fjalë, paraqiti vërejtjet rreth shëndetësisë dhe përkujdesjes sociale, pasi që ka vizita shumë, kurse participime pak. Pastaj tha se emërtimi i shërbimeve të cilat i ka niveli primar, shërbimi teknik dhe i transportit mund të shkojnë bashkë. Në vazhdim tha se pajisjet nuk janë të siguruar në nivelin që e kërkon momenti dhe koha dhe shtoi se sëmundjet ngjithëse që figurojnë në raport, nuk figuron sëmundja e TBC-së e cila ka shënuar rritje, prandaj është dashtë të jepet vlerësimi adekuat përmes dispanzerit, të sigurohen barëra, si dhe të gjithë familjarët të jenë nën kontroll dhe përkujdesje. Në fund tha se ka dhënë vërejtje që në shërbimin e vaksinimit nuk ka mjek të rregullt, i cili kishte me kryer punën e vet për të ndërtuar gjenerata të reja me imunizim të plotë.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - paraqiti sqarime shtesë lidhur me raportin në fjalë.

5. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e korrje-shirjeve dhe përgatitjet për mbjelljet vjeshtore.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit - tha se informata në fjalë ka gabime drejtshkrimore dhe është shumë konfuze dhe shtoi se informata është dashtë të hartohet në kohën e kryer.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit - tha se kjo informatë është hartuar sikur të flitej para korrje-shirjeve dhe e njëjta nuk është korrekte, sepse do të duhej të tregonte sesi ka shkuar procesi i korrje-shirjeve. Po ashtu tha se një vërejtje ia adresoi edhe kryetarit të komunës, sepse informata në fjalë para se të vjen në kuvend ka kaluar përmes kryetarit të komunës, por e njëjta informatë ka shkuar në shqyrtim edhe në KPF, që nënkupton se as KPF-ja nuk ka qenë e vëmendshme.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit - duke iu referuar informatës në fjalë, tha se titulli i informatës dallon plotësisht nga përmbajtja e kësaj informate, pasi që nuk flet asgjë për përgatitjet për mbjelljet vjeshtore, prandaj duhet të obligohet drejtoria përkatëse për të na dhënë shënime përkatëse, në mënyrë që të ketë një raport korrekt.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - tha se në informatën në fjalë janë disa shifra që janë bazë e mirë për t'u orientuar dhe kuptuar sesi kanë shkuar korrje-shirjet në komunën tonë. Pastaj tha se është pozitive që ka rendimente të mira në korrje-shirje në Komunën e Vushtrrisë dhe shtoi se në këtë vit rendimentet e patateve janë shumë të mira.

6. Shqyrtimi i Draft-buxhetit për vitin 2014 (shqyrtimi i parë).

Bajram Mulaku, kryetar i komunës - paraqiti sqarime shtesë lidhur me draft-buxhetin në fjalë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Jepet në diskutim publik Draft-buxheti për vitin 2014 dhe lista e projekteve prioritare. Diskutimi publik fillon nga data 11.09.2013 dhe zgjat deri më 24.09.2013.

7. Të ndryshme.


Refik Ramaj, anëtar i kuvendit - kërkoi për mbledhjen e ardhshme të KK-së një informatë për nxjerrjen e patateve.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit - ngriti shqetësimin për çështjen e vendosjes së policëve të shtrirë në rrugë, duke shtuar se ka rrugë që mungojnë policët e tillë, por që ka shumë nevojë për vendosjen e tyre, pasi që disa vozitës të papërgjegjshëm po zhvillojnë shpejtësi tepër të madhe dhe po rrezikojnë fëmijët nëpër rrugë, kurse në disa rrugë po vendosen policët e shtrirë vend e pa vend pa asnjë autorizim, prandaj kryetari i komunës së bashku me Drejtorinë për Shërbime Publike, të marrin masa që vendosjen e policëve të shtrirë ta bëjë drejtoria përkatëse përmes përgjegjësve të vet për komunikacion, sepse duhet të vendosen në mënyrë profesionale.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit - kërkoi nga drejtori për urbanizëm që në mbledhjen e ardhshme të KK-së të sjellë listën për lejet e lëshuara të ndërtimit prej vitit 2010, duke përfshirë dokumentacionin, sa janë paguar taksat e ndërtimit, si dhe cilat objekte janë pajis me certifikatë të përdorimit.

Mbledhja përfundoi në orën 15:35.

Procesmbajtësi


Alban Tahiraj

Kryesuesi i Kuvendit


Habib Mustafa

